



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1307/2Prot.

Tiranë, më 01.10.2025

V E N D I M

Nr. 229, Datë 01.10.2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa me nr. 194, datë 15.09.2025, e z. A. N., kundër Spitalit Rajonal Durrës dhe Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, në të cilën pretendon të jetë diskriminuar për shkak të “*çdo shkakut tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: *Rasti i pacientit M.K. Pacienti është paraqitur 3 herë në urgjencën e spitalit rajonal Durrës (19.06.2025, 28.06.2025 dhe 03.07.2025). Më datën 03.07.2025, pas rekomandimeve të mjekut R.K., pacienti ka kërkuar të bëjë klizmë në shërbimin e urgjencës dhe cilësoj se pacienti nuk ka ardhur nga dera kryesore hyrëse e urgjencës, por nga brenda spitalit, gjë që tregonte se nuk ishte urgjencë kirurgjikale, por rekomandim i një mjeku tjetër. Në datën 03.07.2025 është parë nga unë (mjek kirurg specialist), i thirrur për konsult nga mjekja e urgjencës. Kam trajtuar rastin në shërbimin e urgjencës ku pacienti është ankuar për fryrje barku, por pa dhimbje barku. Gjatë vizitës kam konstatuar se pacienti kishte probleme kronike të natyrës gastrointestinale dhe i është rekomanduar të ndjekë konsultime të mëtejshme përmes mjekut të familjes, duke përfshirë echografi, skaner, kolonoskopi etj., siç është dokumentuar edhe në kartelën përkatëse. Pacienti është larguar nga urgjenca me rekomandim për ndjekje të mëtejshme. Më pas më është bërë me dije se pacienti është drejtuar në një spital privat, ku është diagnostikuar me kancer të zorrës dhe është operuar. Familjarët e pacientit*

kanë paraqitur ankesë në portalin e bashkëqeverisjes, duke pretenduar se nuk i është ofruar trajtimi i duhur në urgjencë. Një grup pune nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (DROSHKSH) ka hetuar rastin dhe ka rekomanduar masa disiplinore ndaj stafit mjekësor që ka trajtuar pacientin në datat përkatëse. Sipas vendimit të tyre, pretendohet se nuk janë zbatuar protokollat për dhimbje barku, edhe pse në dokumentacion nuk ka prova që pacienti ka shfaqur dhimbje të forta barku në datën 03.07.2025. Kartelat për datat 28.06.2025 dhe 03.07.2025, megjithëse ekzistojnë, janë shpallur të pavlefshme për mungesë vule dhe firme. Në përfundim, është marrë masa disiplinore ndaj meje dhe 4 kolegëve të tjerë: “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, me arsyetimin: “Mos pasqyrim i vizitës dhe trajtimit si dhe moszbatim i protokollit të trajtimit.” Kam trajtuar pacientin me profesionalizëm dhe etikë, bazuar në gjendjen që paraqiti në urgjencë. Kartela mjekësore për datën 03.07.2025 ekziston dhe është plotësuar sipas praktikës së zakonshme. Mungesa e vulës nuk e bën automatikisht dokumentin të pavlefshëm, përderisa përmbajtja ekziston dhe është e qartë. Kam dhënë udhëzimet dhe këshillat e nevojshme për ndjekje të mëtejshme. Nuk kam qenë përgjegjës për ndjekjen e mëtejshme, pasi kjo i takon pacientit dhe mjekut të familjes. Masa disiplinore ndaj meje përmban mospërputhje në arsyetim. Në vendimin zyrtar thuhet se nuk është zbatuar protokollin e trajtimit, ndërkohë që në të njëjtin dokument thuhet se kartelat janë shpallur të pavlefshme. Kjo përbën kontradiktë logjike dhe procedurale: nëse kartela është e pavlefshme, nuk mund të përdoret për të argumentuar se “nuk është zbatuar protokollin”, ndërsa nëse ekziston dhe është e vlefshme, duhet të merret në konsideratë për përmbajtjen e saj. Masa është marrë pa konsultim me Urdhrin e Mjekut, në kundërshtim me ligjin për profesionin e mjekut. Është aplikuar ndëshkim kolektiv, pa analizë individuale të veprimeve të secilit mjek. Nuk na është vënë në dispozicion asnjë protokoll zyrtar për trajtimin e dhimbjes barkut, ndaj nuk mund të pretendohet “moszbatim protokollin” pa e bërë të njohur protokollin në fjalë. Gjatë përballjes me këtë situatë, kam qenë subjekt i presionit dhe sjelljeve kërcënuese nga familjarët e pacientit, në prani të autoriteteve shtetërore, dhe institucioni nuk ka marrë asnjë masë për të garantuar sigurinë time dhe dinjitetin profesional.

Masat që kërkohen të ndërmerren nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Hetimin e plotë administrativ të çështjes, konstatimin e diskriminimit të subjekti ankues z. A. N., anulimin e masës disiplinore dhe kompesimin financiar për dëmin e pësuar.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 1307/1 prot., datë 16.09.2025, të Komisionerit, është kërkuar nga subjekti ankues që të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si më poshtë:

- Shpjegime të hollësishme mbi shkakun e diskriminimit të pretenduar në ankesë, duke përcaktuar qartë se cila është karakteristika apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet

se ka ndikuar në sjelljen diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju e mbartni këtë shkak të pretenduar.

- Përveç përshkrimit të shkakut, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si ky shkak ka ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tij.
- Informacion nëse e keni adresuar ankesën tuaj pranë ndonjë institucioni tjetër kompetent, në përputhje me hierarkinë administrative apo procedurat e brendshme të institucionit ku punoni. Nëse po, ju lutemi bashkëngjitni një kopje të ankesës së paraqitur dhe përgjigjen zyrtare të marrë nga institucioni përkatës.
- Informacion nëse këtë çështje po e ndiqni gjyqësisht; nëse po, na vini në dispozicion kopje të kërkesë-padisë së depozituar pranë gjykatës.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do ta gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, ankuesi ka dërguar një përgjigje me email në datën 23.09.2025, ku ndër të tjera thekson sa më poshtë:*Shkaku i diskriminimit është: statusi im si mjek me përvojë të gjatë në sistemin publik shëndetësor dhe qëndrimi im kritik ndaj problematikave institucionale. Unë mbaj profil personal me mbi 25 vite përvojë, me një reputacion të ndërtuar mbi zërin e brendshëm kritik për mungesat e protokolleve, pajisjeve, mbështetjes administrative dhe problemeve sistematike në menaxhimin e spitalit. Kam ngritur zërin disa herë për problematikën që lidhen me kushtet e punës, mungesën e protokolleve dhe mungesën e pajisjeve diagnostikuese. – Kam qenë pjesë e diskutimeve të brendshme në spital ku kam artikuluar nevojën për standardizimin e trajtimeve dhe mbrojtjen e stafit nga presione të jashtme. Kam mbajtur qëndrim profesional të dokumentuar me shkrim në lidhje me rastin e pacientit M. K., në datën 03.07.2025.....*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura

nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Përsa i takon pretendimit të palës ankuese për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh².

¹ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

² Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statute të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se pretendimi i ankuesit për diskriminim, në mungesë të specifikimit të një shkak apo të një karakteristike personale të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur” sipas ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” të ndryshuar, (siç janë: *raca, etnia, ngjyra, gjuha, shtetësia, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, karakteristikat e seksit, jetesa me HIV/AIDS, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamja e jashtme, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, apo çdo karakteristikë tjetër e mbrojtur nga ligji*), e vështirëson procesin e vlerësimit të rrethanave si diskriminuese në kuptimin ligjor.

Ekzistenca e një shkak apo të mbrojtur është një element thelbësor për të vlerësuar nëse trajtimi i pretenduar përbën një shkelje të mundshme të të drejtave të punëmarrësit në formën e diskriminimit. Për rrjedhojë, në mungesë të provave të mjaftueshme që lidhen drejtpërdrejt me ndonjë shkak të mbrojtur ligjërisht, ankesa nuk përmbush kriteret ligjore për të vijuar më tej si një çështje

diskriminimi në kuptimin e nenit 3 dhe 3/1 të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar.

Ankuesi nuk ka arritur të provojë me prova konkrete shkakun e pretenduar të diskriminimit, pasi pretendimet e tij mbeten në nivel deklarativ dhe të natyrës subjektive, pa u shoqëruar me dokumentacion, fakte apo dëshmi që të vërtetojnë ekzistencën e një trajtimi të pabarabartë për shkak të statusit të tij si mjek me përvojë apo për shkak të qëndrimeve të tij kritike ndaj institucionit. Pavarësisht se ai përmend se ka ngritur shqetësime për mungesën e protokolleve dhe pajisjeve, nuk janë paraqitur akte të brendshme, procesverbale, komunikime zyrtare apo ndonjë dokument tjetër që të mbështesë lidhjen shkak-pasojë midis këtyre qëndrimeve dhe masës disiplinore të marrë ndaj tij. Në mungesë të një baze të qartë provuese, pretendimi për diskriminim mbetet i pabazuar dhe nuk plotëson kriteret për tu trajtuar si rast i diskriminimit të ndaluar ligjërisht.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një çështje që përfshihet në juridiksionin material të këtij institucioni, sipas përcaktimeve të legjislacionit përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi.

Palës ankimuese, i lind e drejta të ndjekë rrugët e tjera të parashikuara në legjislacionin për marrëdhëniet e punës dhe në kuadrin institucional të sistemit shëndetësor, nëse konsideron se janë shkelur të drejtat e tij në raportin e punës apo në procedurat e brendshme të institucionit punëdhënës. Këto rrugë përfshijnë paraqitjen e ankesës pranë Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhrit të Mjekut, Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. Dhe nëse nuk gjendet zgjidhje administrative ose institucionale, ndjekjen e procedurës gjyqësore përmes gjykatave kompetente, për të kërkuar konstatimin e shkeljeve të pretenduara, dëmshpërblim, rivendosje në të drejtë së tij apo masa të tjera që ligji ka parashikuar.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë se nuk plotësohen kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues z. A. N., pasi bazuar në ligjin nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* të ndryshuar, nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA